




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 149, datë 20.3.2019

PËR

**KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KARAKTERISTIKAT
E PËRDORIMIT E AKSESIMIT, TË DHËNAT PARËSORE E DYTËSORE
DHE DHËNËSIN E INFORMACIONIT TË SISTEMIT TË INTEGRUAR
TË TË DHËNAVE TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave lidhur me krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.
2. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal, ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin penal, të mitur viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale.
3. Përdorimi dhe aksesimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit mbështetet në:
 - a) parimin e respektimit të jetës private, të dinjitetit dhe personalitetit të të miturit;
 - b) parimin e konfidencialitetit, duke mos bërë publike asnjë të dhënë ose informacion të marrë për shkak të detyrës/gjatë kryerjes së detyrës dhe pas përfundimit të saj, që mund të lidhet me dënimet e mëparshme të të miturit, në respektim të legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

- c) parimin e interesit më të lartë të të miturit.
4. Krijimi, funksionimi dhe administrimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur bëhet në formatin “*web-based*”.
5. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si bazë të dhënash shtetërore, hostohet në serverët e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim, AKSHI).
6. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rubrika të posaçme për anonimizimin e të dhënave, që identifikojnë të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose dëshmitar të një vepre penale, të dhëna sensitive të lidhura me emrat, adresat, vendet e shkollimit dhe/ose të punës, të profesioneve ose çdo informacion tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të miturin.
7. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka për qëllim, si më poshtë vijon:
- a) mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të rasteve të drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore;
 - b) përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara nga ky vendim;
 - c) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën e orientimin e përmirësimit të politikave lidhur me drejtësinë penale për të mitur;
 - ç) ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur i mituri është subjekt i abuzimeve ose shkeljeve të garancive procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
8. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është një sistem unik digjital, që gjeneron tregues bazë në mënyrë sintetike për:
- a) gjendjen e kriminalitetit për të miturit;
 - b) numrin e përsëritësve nga grupmoshat e mitura;
 - c) shkallën e riintegritimit apo rehabilitimit të të miturve pas kryerjes së dënimit me burgim ose në rastet kur nuk janë dënuar me burg;
 - ç) numrin e të miturve në konflikt me ligjin të proceduar në gjendje lirë, të arrestuar, të ndaluar;
 - d) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të trajtuar me procedurën e shmangies nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative;

- dh) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të gjykuar e të dënuar;
- e) llojin e veprave penale të kryera nga të mitur;
- ë) numrin e viktimave të mitura dhe llojin e veprave penale të kryera ndaj tyre; si dhe
- f) të dhëna të tjera që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin.

9. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përbëhet nga tërësia e të dhënave që burojnë nga fashikujt e dokumente të krijuara, të dërguara dhe të përpunuara gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, gjatë procedurave që ndiqen në hetimin ose gjykimin e çështjeve që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin, të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar. Në të dhënat e detyrueshme, që organet kompetente duhet të hedhin në version elektronik, të jenë:

- a) vendimet e gjykatave;
- b) vendimi i prokurorit për fillimin, mosfillimin ose shmangien nga ndjekja penale;
- c) marrëveshja e shmangies nga ndjekja penale;
- ç) raportet e vlerësimit individual të të miturit;
- d) vendimet për ekzekutimin e vendimeve penale;
- dh) dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga i mituri me marrëveshje, si: dëftesa shkollë, vërtetime për ndjekjen e programeve, si dhe akte të tjera;
- e) lloji i veprës penale të evidentuar, si dhe të dhëna për identitetin, gjininë, arsimin dhe vendbanimin për të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë;

10. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna që ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

- a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e administruara nga institucioni përgjegjës dhe që kanë të bëjnë me:
 - i) të miturit autorë, viktimë apo dëshmitarë të një veprë penale; si dhe
 - ii) çdo të dhënë tjetër që lidhet me të miturit në konflikt me ligjin.
- b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë të bëjnë me:
 - i) veprat penale të evidentuara nga strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për të miturit në konflikt me ligjin, duke përfshirë: llojin e veprës penale, datën e evidentimit, strukturën policore që e ka

- evidentuar dhe/ose trajtuar rastin, masën e marrë ndaj të miturit (gjendje e lirë, arrestuar, ndaluar, shpallur në kërkim);
- ii) njoftimet dhe kallëzimet e kryera pranë organeve të ndjekjes penale për një veprë penale të dyshuar se është kryer nga një i mitur, duke përfshirë: datën e kallëzimit, prokurorinë ku bëhet kallëzimi, numrin e të miturve, veprën penale të dyshuar se është kryer nga i mituri, vendimin e prokurorisë;
 - iii) të dhënat që merren nga institucionet e ekzekutimit të vendimit, duke përfshirë: dënimin/masën e dhënë, afatin për kryerjen e dënimit/masës, institucionin/zyrën që do ta ndjekë, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me procesin;
 - iv) të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa;
 - v) procesin gjyqësor të kryer nga gjykata, duke përfshirë: të dhënat mbi akuzën e ngritur nga prokuroria, datën e numrin e regjistrimit të çështjes, llojin e gjykimit, vendimin e gjykatës, numrin të miturve të dënuar, llojin e dënimit;
 - vi) të dhënat e marra nga baza të tjera të dhënash, ku ato janë të dhëna parësore.

11. Subjektet përgjegjëse të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë, si më poshtë vijon:

- a) Institucioni administrues i sistemit është Ministria e Drejtësisë;
- b) Institucionet përgjegjëse si dhënës për popullimin me të dhëna sipas fazave të procesit janë:
 - i) Ministria e Brendshme;
 - ii) Prokuroria e Përgjithshme;
 - iii) Të gjitha gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;
 - iv) Gjykata e Lartë;
 - v) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
 - vi) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

12. Përdoruesit e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë hedhësit e informacionit, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe/ose drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin;

- b) Zyrat/seksionet e prokurorisë në nivel rrethi dhe apeli, që hetojnë çështje penale me të mitur;
- c) Gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;
- ç) Gjykata e Lartë;
- d) Prokuroria e Përgjithshme;
- dh) Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur;
- e) Zyrat vendore të shërbimit të provës që trajtojnë rastet e të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim.

13. Subjekte të interesuara janë:

- a) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- ç) ministria përgjegjëse për arsimin;
- d) çdo subjekt tjetër, që paraqet kërkesën e argumentuar pranë ministrit të Drejtësisë dhe i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Të dhënat lidhur me të miturin dhe procedurën që parashikon ky vendim mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

15. Pas lirimit të të miturit, për fashikullin e tij personal elektronik zbatohen rregullat për ruajtjen dhe asgjësimin e fashikujve, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

16. Niveli i aksesit në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është, si më poshtë vijon:

- a) Subjektet e përcaktuara në pikën 11, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tyre në sistem;
- b) Subjektet e përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi, shkrimi e modifikimi mbi të dhënat e hedhura prej tyre;
- c) Subjektet e përcaktuara në pikën 13, të këtij vendimi, kanë akses në nivelin “vizitor” mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemi dhe dokumentet e prodhuara, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të të dhënave e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale të të miturit të mbrojtura nga ligji;
- ç) Ministria e Drejtësisë ka të drejta të plota administrative në sistem në këto role:

- i) administrator;
- ii) raportues;
- iii) auditues;
- iv) zhvillues.

17. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ndërvepron me bazat e të dhënave ku ato ekzistojnë si të dhëna parësore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
18. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale të institucioneve, të cilat nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem, sigurojnë që informacioni t'i dërgohet menjëherë organit epror, i cili ka llogari në sistem. Organi epror, nëpërmjet llogarisë së tij, plotëson sistemin në emër të institucionit që ka dërguar të dhënat. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale dhe institucionet eprore marrin të gjitha masat që komunikimi i të dhënave mes tyre dhe hedhja e të dhënave në sistem të përfundojë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, po jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i krijimit të informacionit nga institucioni dërgues. Për raste të veçanta, hedhja e informacionit nuk mund jetë përtej 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti i krijimit.
19. Ministria e Drejtësisë kujdeset që të mundësohet grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre statistikor, analiza dhe përgatitja e raporteve për përmirësimin dhe parandalimin e kriminalitetit, ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur të miturit i mohohet aksesit në drejtësi ose kur nuk zbatohen garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe:
- a) të vendosë në dispozicion të përdoruesve të sistemit programin për hedhjen e të dhënave në formatin “*web-based*”;
 - b) të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me AKSHI-n për hostimin e sistemit;
 - c) të mbikëqyrë dhe të ofrojë asistencë teknike për përdorimin e sistemit;
 - ç) të vendosë në dispozicion të organeve shtetërore mundësinë e gjenerimit automatik të statistikave nga sistemi për të dhënat e hedhura nga secili institucion;
 - d) të trajtojë përdoruesit e sistemit lidhur me raportimin, hedhjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të sistemit, sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi;
 - dh) të propozojë masa për rritjen e efikasitetit të sistemit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

20. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura nëpërmjet llogarisë së tyre në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.
21. Subjekti përgjegjës për administrimin e sistemit në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
22. AKSHI, si autoriteti rregullator koordinues i bazave të të dhënave shtetërore, regjistron, auditon dhe koordinon ndërveprimin me bazat e të dhënave shtetërore.
23. Përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur fillon nga data e vënies në funksionim e tij.
24. Ngarkohen institucionet shtetërore, që hedhin të dhënat sipas fushave të veprimtarisë, për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit nga institucionet e tyre të varësisë.
25. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I DREJTËSISË

ETILDA GJONAJ

NR.PROT.325/3
DATË 21.3.2019

MINISTRISË SË DREJTËSISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT
MINISTRISË SË BRENDSHME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
POLICISË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
GJYKATËS SË LARTË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
BURGJEVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

